



REPUB LIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Udhëheqësi i Personelit
01Nr.- 111/01-26035 dt. 07/05/2018

Bazuar në nenin 11 dhe 12 ,paragrafi 1.1 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit shpall:

KONKURSIN PUBLIK

1 (një) Zyrtar për leje ndërtimore

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllogoc
Nr. i references:	2
Pozita e punës:	Zyrtar për leje të ndërtimore UNM/080
Institucioni:	Drejtorati i Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
Divizioni/njësia:	Sektori i Ndërtimit
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional,grada 9, Koeficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 9

Koeficienti 7, Drejtorati i Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Administratën Komunale - Drenas.

Detyrat Kryesore:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike rreth lejve ndërtimore , certifikatave të përdorimit ;
2. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret që lidhen me fushën e planifikimit, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara;
4. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative ;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturesë - Bachelor i Arkitekturesë dhe Bachelor i Ndërtimit, **2 vite** përvoj pune profesionale.

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (AutoCad , ArchiCad ,Word, Excel, Power Point, Access); Aftësi komunikuese me eprorin, kolegë dhe palë.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i pare, sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shërbyesit civil në Komunën e Drenasit dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e shpalljes **07/05/2018 deri më 21/05/2018**, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesës së komunës dhe shalljes në hyrje të komunës.



U.D. Udhëheqëse e Personelit

Hamumshahe Shabani